







Problema me 3 pikë






1. Cila kuti ka më shumë trekëndësha?



2. Artani e pret këtë vizatim përgjysmë dhe i vendos dy pjesët bashkë.




Cila nga mundësitë tregon dy pjesët e vizatimit të Artanit?




3. Figura tregon 5 tulla të njëjta. Sa tulla janë në kontakt me 3 tulla të tjera?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3
(D) 4 (E) 5



4. Një sanduiç dhe një kuti me lëng së bashku kushtojnë 12 euro. Një sanduiç dhe dy kuti me lëng së bashku kushtojnë 14 euro.



Sa kushton vetëm një kuti me lëng?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

5. Në çdo rresht dhe në çdo shtyllë duhet të jenë 2 monedha.

○	○		B
A	○	C	○
○		D	
E		○	○



Në cilën nga kutitë me shkronja duhet të vendoset monedha e fundit?

- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E






6. Një majmun ka grisur një pjesë nga harta e Kapiten Xhekut.



Cila është pjesa që mungon?



7. Petriti bashkoi 4 copat e mëposhtme të lojës formuese (të pazllit) për të formuar një katror. Cilën figurë formoi ai?



8. Mbi një fletë me katrorë u derdh pak bojë, siç tregohet në figurë.
Në sa katrorë është përhapur boja?


(A) 16

(B) 17

(C) 18

(D) 19

(E) 20



Problema me 4 pikë

9. Kaltrina shkroi një numër dhe pastaj mbuloi secilën shifër me një nga format e figurës në të djathtë. Shifrat e ndryshme u mbuluan me forma të ndryshme dhe shifrat e njëjta u mbuluan me të njëjtën formë. Cili nga numrat e mëposhtëm është shkruar nën këtë figurë?



- (A) 34426 (B) 34526 (C) 34423 (D) 34424 (E) 32446


10. Në secilën prej shportave të mëposhtme fle një kafshë. Ariu dhe dhelpra po flejnë në shporta me të njëjtin model dhe të njëjtën formë.



Kanguri dhe struci po flejnë në shporta me të njëjtën lloj thurjeje. Në cilën shportë po fle qenushi?

- (A) shporta 1 (B) shporta 2 (C) shporta 3 (D) shporta 4 (E) shporta 5


11. Kanguri Kanga dëshiron të arrijë te arushi duke mos kaluar nëpër asnjë katror me bojë.



Cilën rrugë duhet të ndjekë ai?

- (A) (B) (C) (D) (E)

12. Në një nga figurat e mëposhtme, është përdorur një formë që nuk është përdorur në figurat e tjera. Cila është kjo figurë?




13. Cila nga figurat e mëposhtme është pamja që shihet nga sipër e këtyre disqeve vendosur njëri mbi tjetrin?





- (A) (B) (C) (D) (E)

14. Cilën nga figurat e mëposhtme do të shohim kur përdorim vulën ?



- (A) (B) (C) (D) (E)


15. Kruza ndërton një rrugë rreth secilit katror duke përdorur pllaka si kjo



Sa pllaka përdor ajo rreth një katrori me brinjë me gjatësi 5?

- (A) 10 (B) 11 (C) 12 (D) 14 (E) 16

16. Ana ka këto 4 letra ngjitëse (stikera):



Ajo ngjiti yllin pasi ngjiti katrorin dhe para se të ngjiste trekëndëshin.

Cila është figura që ajo formoi në fund?


- (A) (B) (C) (D) (E)

Problema me 5 pikë


17. Shuma e pesë numrave në secilën shtëpi është 20. Disa nga këta numra janë mbuluar.

Cili numër fshihet nën rrethin me shenjën e pikëpyetjes?

- (A) 3 (B) 4 (C) 7 (D) 9 (E) 14



18. Më poshtë janë treguar disa figura. Cila prej tyre ka sipërfaqen më të vogël?




19. Çdo vit, Marigonës për ditëlindje i dhurojnë arinj lodër. Në ditëlindjen e parë asaj i dhuruan 1 ari lodër. Për ditëlindjen e dytë ajo mori 2 arinj lodra. Për çdo ditëlindje të radhës, asaj i dhuruan një ari lodër më shumë sesa një vit më parë.

Sa arinj lodra kishte gjithsej Marigona pasi mbushi 6 vjeç?

- (A) 19 (B) 20 (C) 21 (D) 22 (E) 23

20. Dinosauri Dino lëviz nga hyrja deri në dalje duke kaluar nëpër disa dhoma. Ai mund të kalojë nëpër secilën dhomë vetëm një herë. Dinosauri i mbledh numrat e dhomave nëpër të cilat kalon.




Sa është shuma më e madhe që mund të formojë Dino?

- (A) 27 (B) 29 (C) 32 (D) 34 (E) 36

21. Në figurë çdo formë përfaqëson një numër të ndryshëm. Cili numër duhet të shkruhet në vend të shenjës së pikëpyetjes?


- (A) 10 (B) 12 (C) 14
(D) 16 (E) 18



22. Në një garë marrin pjesë tri zebra, Rina, Zara dhe Biba. Rina ka 15 vija, ndërsa Zara ka 3 vija më shumë se ajo. Rina ka 5 vija më pak se Biba. Garën e fiton zebra që ka më shumë vija. Sa vija ka zebra fituese?

- (A) 16 (B) 18 (C) 20 (D) 21 (E) 22

23. Makina e Kreshnikut mund të kthehet vetëm majtas, por jo djathtas. Cilën nga pesë rrugët e mëposhtme mund ta bëjë Kreshniku me makinë?



24. Në tavolinë janë 5 letra me numra, siç tregohet në figurë. Çdo herë ju mund të shkëmbeni dy letra. Sa është numri më i vogël i shkëmbimeve të nevojshme për t'i renditur letrat nga numri më i vogël te numri më i madh?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5